

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PER MBROJTJEN E FEMIJEVE

Drejtoria e Shërbimit social pranë bashkisë dëbër ka një plan 4 vjeçar. Brenda planit është dhe plani për mbrojtjen e fëmijëve, ku në bazë të vlerësimit të nevojave kanë dale shërbimet që ofrohen dhe shërbimet që janë të nevojshme të krijohen <

Shërbime për fëmijët

* Aktiviteti NJMF-së pranë Bashkisë.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve që ka rreth 3 vite që është ngritur pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale ka hartuar dhe zbaton procedura si në raport me identifikimin dhe menaxhimin e rasteve specifike të fëmijëve në nevojë për t'u marrë në mbrojtje, ashtu edhe përsa i takon roleve të tjera si atyre ndërgjegjësuëse, koordinuese etj. NJMF bën gjithashtu drejtimin e grupit multidisiplinar për ndjekjen e rasteve si ato të identifikuar nga vetë NJMF apo dhe raste të referuara nga aktorë të tjerë.

Bashkia e Dibrës, bazuar mbi vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e saj dhe përmes diskutimeve me stafin dhe aktorët relevante, janë identifikuar prioritetet e mëposhtme në zhvillimin e shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe atyre të reja dhe i reflekton ato në planin e veprimit 2018-2021:

Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese:

* Informimi i qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre dhe organizimi i dëgjësive publike me pjesëmarrje të qytetarëve

* Riorganizimi dhe përshkrimi i qartë i punës për punonjësit e drejtorisë së shërbimeve sociale dhe administratorët socialë

* Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara, në përgjigje të nevojave të qytetarëve

Zhvillimi i shërbimeve të reja:

* Ndërtimi i një qendre multifunktionale ku ofrohen një sërë shërbimesh për plotësimin e nevojave dhe trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

* Ndërtimi i një qendre sociale që ofron shërbime për fëmijët dhe të rinjtë

* Shërbime të emergjencës për dhunën në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve

* Qendrave ditore komunitare për të moshuar në nivel bashkie

* Shërbime që kanë në foku